



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

---

**Njoftim Paraprak Përqendrimi**

Rasti: Përfitim Kontrolli Olam International Limited - Archer Daniel Midland

Në datën 13 Janar 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshje Blerje Master” e nënshkruar midis Olam International Limited (Blersi ) dhe Archer Daniel Midland (Shitësi), më datë 15 Dhjetor 2014, me objekt përfitim të kontrollit, nga Olam International Limited, të aseteve të zotëruara nga Archer Daniel Midland që i përkasin aktivitetit të biznesit të kakaos. Njoftimi është bërë për xhirove vjetore të realizuara nga Olam International Limited në Shqipëri.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Olam International Limited:** është aktiv kryesisht si një tregtar i zakonshëm ndërkombëtar i mallrave të kokrrave të kakaos dhe përdor një sasi të vogël të kokrrave të kakaos për produkte të kakaos gjysmë të gatshme;
- **Archer- Daniel- Midland:** është një ndërmarrje amerikane që vepron në aktivitetin e prokurimit, transportit, magazinimit dhe tregtimit të mallrave bujqësor dhe produkteve të farave vajore dhe drithërave;
- **Biznesi i kakaos së Archer-Daniel- Midland (targeti):** është pjesë e biznesit më të madh të përpunimit të farave vajore të Archer-Daniel-Midland.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) dhe 2 , pika 1) shkronja a) të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**